



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:192613
Datë: 13.05.2024
Numri i dokumentit: 05677755

Ac.nr.9361/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Naim Mehulli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.M, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Y.B avokat, kundër të paditurit AIG-EUROPE, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.K avokat, për kompensim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.2991/13 e datës 23.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 13.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET si e themeltë ankesa e të paditurës AIG-EUROPE,Czech, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2991/13 e datës 23.07.2021, në pjesën që ka të bëjë me kamatën në të cilën pjesë NDRYSHOHET dhe vendoset ashtu që DETYROHET e paditura, që paditësit t’ia paguajë kamatën të cilat e paguajnë bankat afariste në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për një vit, duke llogaritur për dëme material nga dita e paraqitjes së padisë me 14/11/2013 si dhe për dëme jo material nga data e marrjes së aktgjykimit me 23/07/2021 e deri në pagesën definitive.

II.Aktgjykimi ankimuar C.nr.2991/13 e datës 23.07.2021, në piken I (sa i përket dëmit material dhe jo material), si dhe pika II e III të dispozitivit, mbeten të pa shqyrtuara.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin ankimor C.nr.2991/13 e datës 23.07.2021, ka vendosur si vijon:

I.APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditëses F.M dhe DETYROHET i padituri AIG-EUROPE, qe paditëses në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 10.05.2012, t’ia paguaj shumat e specifikuar si më poshtë:

Dëmin jo material:

- a. Për dhimbje fizike, shumën prej.....1,700.00 €
b. Për friken e përjetuar, shumën prej.....1,400.00 €

Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, nga data 27.07.2021 (data e përpilimit të aktgjykimit 23.07.2021), e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit së këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm

Dëmin material

- a. Për ushqim të përforcuar shumën prej150.00 €
b. Për përkujdesje të personit të huaj shumën prej150.00 €
c. Për shpenzime të mjekimit shumën prej.....400.00 €

Te gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, nga data 14.11.2013 (data e paraqitjes së padisë) e deri në pagesën definitive e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit së këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

II.DETYROHET e paditura AIG-EUROPE, që paditëses F.M, t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 1,251.5 €, e të gjitha këto t'i përmbushë në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

III.REFUZOHET E PABAZUAR pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses F.M mbi shumat e aprovuara dhe atë: për dhimbjet e përjetuara fizike shumën prej 1,300.00 €; për frikën e pësuar shumën prej 700 €; për ushqim të përforcuar shumën prej 850 €, për përkujdesje të personit të huaj shumën prej 850 €; shpenzime materiale në shumën prej 13 €, kurse në tërësi pjesa e kërkesëpadisë për deformim fizik në shumën prej 900.00 euro, si dhe në tërësi pjesa e kërkesëpadisë për kompensim në emër të rehabilitimit shëndetësor në shumë prej 1,087 € si e PA BAZUAR.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim si në ankesë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 lidhur me nenin 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja F.M, përmes të autorizuarit të tij, pranë Gjykatës së shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, për kompensim dëmi, me kërkesë të përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse si dhe të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e të njëjtit. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk ishte kontestues fakti se deri te aksidenti ka ardhur me fajin ekskluziv të drejtuesit të automjetit i cili ka qenë i siguruar

te e paditura, po ashtu nuk ishte kontestuese fakti se paditësja i është nënshtruar shërbimeve mjekësore shëndetësore pranë institucioneve përkatëse dhe nga ekspertiza mjekësore e punuar nga ekspertet e mjekësorë nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë, të punuar nga Dr.Xh.S-Ortoped dhe Dr.V.A-S-Psikiatër, është vërtetuar se paditësja ka pësuar lëndime të lehta trupor e që është manifestuar me dhimbje fizike, frik dhe format tjera të dëmit, të përshkruara si në arsyetimin e aktgjykimit. Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar neneve 137, 183 të LMD-së si dhe neneve 449 dhe 452 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit rezulton se ankesa e të paditurës është e bazuar, për arsye se gjykata e shkallës së parë gjatë aplikimit të ligjit material, nuk e ka pasur parasysh se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me datën 10/05/2012, ndërsa Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve i cili është aplikuar në rastin konkret ka hyrë në fuqi me datën 20/12/2012 dhe sipas nenit 1057 të LMD-së parashihet: *Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para hyrjes në fuqi të këtij ligji* dhe mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, Gjykata e Apelit e ka bërë ndryshimin e aktgjykimit në kuptim të dispozitës së nenit 195 paragrafi 1 pika (e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika (d) e LPK-së, meqenëse ka gjetur se nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, por sipas kësaj gjendje faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë është zbatuar gabimisht e drejta materiale përkitazi me lartasin e kamatës, për çka është dashur që të ndryshohet aktgjykimi i atakuar dhe në bazë të nenit 277 të LMD-së, paditëses duhet ti njihet kamata të cilat e paguajnë bankat afariste në Kosovë sikurse për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar për një vit, ashtu siç parashihet edhe me Mendimin Juridik për Kamatë të Gjykatës Supreme të Kosovës Gja.nr.265/20 e datës 02/12/2020.

Pika I (sa i përket dëmit material dhe jo material), si dhe pika II e III e dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, nuk është shqyrtuar nga kjo gjykatë, pasi që në bazë të thënieve nga ankesa e ushtruar, kjo gjykatë ka konstatuar se në këtë pjesë aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur nga palët ankuese.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195 par.1 pika d) dhe e) e lidhur me nenin 201 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
Ac.nr.9361/21, me datë 13.05.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku